

1. Informacion i përgjithshëm

ARC sh.p.k është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, me NUIS K81728025F, në përputhje me ligjin 9901 datë 19.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe nga statuti i saj. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është shërbime logjistike, organizim i udhëtimeve individuale dhe kolektive për stafe profesionale, rezervime, shërbime guide. Masterplane-studime rajonale dhe urbanistike.

Zyra qendrore e Shoqërisë ndodhet në rrugën "Themistokli Gërmenji", Pallati përballë RTSH, Kati 1. Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 100,000 Lek dhe zotërohet nga ortakut i vetëm Z. Besnik Leskaj.

Në 31 dhjetor 2021 shoqëria ka 20 punonjës. (2020: 26 punonjës)

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5 Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.5 Vlerësime dhe gjykime (vazhdon)

2.5.1 Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2 Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet (SKK) të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme. Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 është riparaqitur për të korresponduar me paraqitjen e re të pasqyrave financiare siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) të përmirësuara.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.1. Transaksionet në monedhë të huaj (vazhdim)**

Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2021	2020
Euro/LEK	120.76	123.70
USD/ LEK	106.54	100.84

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuara duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huaqë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali

Kapitali njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivët financiarë të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivët e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivët financiarë të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)***iii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2021 dhe 2020 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje zyre dhe informatike	Vlera e mbetur	25 %
Mobilje zyre	Vlera e mbetur	20 %
Mjete Transporti	Vlera e mbetur	20 %

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Pagesat e bëra për qiratë operative njihen në të ardhura ose shpenzime në mënyrë lineare gjatë afatit të qirasë.

Shoqëria ka qira operative dhe financiare.

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2021 është 15% (2020: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohshme për njohjen e tatimi të shtyrë.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.11. Transaksionet me palët e lidhura**

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Mjete monetare në banke	19,683,526	3,958,797
Në Lekë	-	-
Në monedhë	19,683,526	3,958,797
Mjete monetare në arkë	1,942,257	5,523,880
Në Lekë	26,568	-
Në monedhë	1,915,689	5,523,880
	<u>21,625,783</u>	<u>9,482,677</u>

5. Huadhënie afatshkurtër

Huadhënia afatshkurtër më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Huadhënie M&P I	26,204,920	26,842,900
Huadhënie ASG	27,500	27,500
Huadhënie Landways D.o.o	10,868,400	-
	<u>37,100,820</u>	<u>26,870,400</u>

6. Hua afatshkurtër ndaj palëve të lidhura

Hua afatshkurtër ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Huadhënie Albrail	20,348,060	30,739,450
Huadhënie Blessed Investment	-	50,000
Huadhënie GBI	7,538,000	7,685,000
	<u>27,886,060</u>	<u>38,474,450</u>

7. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Klientë EUR	21,249,713	7,717,184
Klientë ALL	3,005,163	3,625,079
	<u>24,254,876</u>	<u>11,342,263</u>

8. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Të arkëtueshme tregtare Abkons	17,665,386	40,145,151
Te arkëtueshme nga GBI	21,737	22,266
TE arkëtueshme nga Ikons	3,457,809	11,133
TE arkëtueshme nga AFI	-	82,879
Të arkëtueshme nga BGP Southeast Europe	724,560	729,830
	<u>21,869,492</u>	<u>40,991,259</u>

9. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Tatim fitimi i arkëtueshëm	1,853,442	1,561,796
TVSH e paguar ne dogane	51,173	1,859,557
TVSH e arkëtueshme	-	724,074
Garanci të dhena	944,901	862,369
Të tjera të arkëtueshme	6,242,357	6,526,537
	<u>9,091,873</u>	<u>11,534,333</u>

10. Inventarë

Inventari detajohet si më poshtë më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Mallra	106,845,203	78,221,272
Parapagime per mallra	22,361,996	
	<u>129,207,199</u>	<u>78,221,272</u>

11. Parapagime dhe shpenzime të shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Parapagim/Garanci per Kumtel Dayanikli Tuketim	30,708,685	42,436,300
Parapagim Gener 2	18,597,040	-
Shpenzime te shtyra dhe parapagime te tjera	126,177	1,305,077
	<u>49,431,902</u>	<u>43,741,377</u>

12. Investime në pjesëmarrje

Investimet në pjesëmarrje detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
16.85% Aksone në kompanie Albrail	22,798,050	22,798,050
50% Aksone në kompaninë GBI	-	-
	<u>22,798,050</u>	<u>22,798,050</u>

13. Huadhenie afatgjatë

Huadheniet afatgjata detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Huadhenie Kastriot Shehu	12,076,000	-
Huadhenie GBI International HUB	7,970,160	-
	<u>20,046,160</u>	<u>-</u>

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Vlerat janë në Lek)

14. Aktive Afatgjata Materiale

<i>Kosto</i>	Mobilje dhe orendi	Pajisje informatike	Punë në ambjente të marra me qera	Mjete transporti	Totali
Gjendja më 01 janar 2020	14,134,262	910,468	11,497,946	89,799,609	116,342,285
Shtesa	3,061,213	455,203	970,452	10,516,283	15,003,151
Pakesime	-	(291,213)	-	(13,686,702)	(13,977,915)
Gjendja më 31 dhjetor 2020	17,195,475	1,074,458	12,468,398	86,629,190	117,367,521
Shtesa	275,126	401,822	-	-	676,948
Pakesime	-	-	-	(35,374,484)	(35,374,484)
Gjendja më 31 dhjetor 2021	17,470,601	1,476,280	12,468,398	51,254,706	82,669,985
<i>Amortizimi i akumuluar</i>					
Gjendja më 01 janar 2020	7,950,793	497,232	2,841,264	39,399,686	50,688,975
Amortizimi i vitit	1,631,496	178,524	1,795,837	9,627,392	13,233,249
Pakesime	-	(43,241)	-	(6,923,833)	(6,967,074)
Gjendja më 31 dhjetor 2020	9,582,289	632,515	4,637,101	42,103,245	56,955,150
Amortizimi i vitit	1,560,383	185,804	1,566,259	7,355,933	10,668,379
Pakesime	-	-	-	(20,337,522)	(20,337,522)
Gjendja më 31 dhjetor 2021	11,142,672	818,319	6,203,360	29,121,656	47,286,007
<i>Vlera neto kontabël</i>					
Gjendja më 31 dhjetor 2020	7,613,186	441,943	7,831,297	44,525,945	60,412,371
Gjendja më 31 dhjetor 2021	6,327,929	657,961	6,265,038	22,133,050	35,383,978

15. Aktive afatgjata Jomateriale

Aktivitet afatgjata jomateriale më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 detajohen si më poshtë:

	AAJM
Kosto	
Gjendja më 1 janar 2020	158,434
Shtesa	291,213
Gjendja më 31 dhjetor 2020	449,647
Shtesa	-
Gjendja më 31 dhjetor 2021	449,647
Amortizimi i akumuluar	
Gjendja më 1 janar 2020	13,863
Amortizimi i vitit	43,237
Gjendja më 31 dhjetor 2020	57,100
Amortizimi i vitit	61,994
Gjendja më 31 dhjetor 2021	119,094
<i>Vlera neto kontabël</i>	
Gjendja më 31 dhjetor 2020	392,547
Gjendja më 31 dhjetor 2021	330,553

16. Hua afatshkurtra

Huaja afatshkurtër më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Overdraft Tirana Bank	61,564,030	26,727,306
	61,564,030	26,727,306

17. Llogari të pagueshme tregtare

Llogari të pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Furnitorë në lekë	27,310,145	14,164,265
Furnitorë në monedhë	7,216,333	15,177,725
	34,526,478	29,341,990

18. Pjesa afatshkurtër e qirasë financiare

Pjesa afatshkurtër e qirasë financiare më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 detajohet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Pjesa afatshkurtër e qirase financiare	1,239,601	7,026,590
Pjesa afatgjate e qirase financiare	4,991,661	6,643,927
	<u>6,231,262</u>	<u>13,670,517</u>

19. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Detyrime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	368,347	649,713
Detyrime për tatimin mbi të ardhurat personale	172,737	399,629
Tatim në burim	18,179	360,000
TVSH për t'u paguar	2,787,780	-
Të tjera tatime për tu paguar	-	4,058,814
	<u>3,347,043</u>	<u>5,468,156</u>

20. Garanci të marra

Garancitë e marra më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Garanci të marra	640,028	655,610
	<u>640,028</u>	<u>655,610</u>

21. Detyrime ndaj palëve të lidhura

Detyrimet ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Huadhenie Blessed Investment	31,681,200	39,584,000
Detyrime për dividend ndaj Besnik Leskaj	142,544,564	142,544,564
	<u>174,225,764</u>	<u>182,128,564</u>

22. Të tjera detyrime

Të tjera detyrime më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Paga të pagueshme	1,741,631	2,879,533
	<u>1,741,631</u>	<u>2,879,533</u>

23. Kapitali

Kapitali i nënshkruar nuk ka patur ndryshime dhe mbetet në total prej 100,000 lekë.

Fitimi i mbartur më 31 dhjetor 2021 është 83,289,323 lekë. (31 dhjetor 2020: 59,148,993 lekë).

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Numri i përgjithshëm i kuotave	1	1
Vlera nominale	100,000	100,000
	<u>100,000</u>	<u>100,000</u>

24. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>
Te ardhura nga shitja e mallrave	206,385,956	124,244,012
Të ardhura nga shërbimet e logjistikës	13,010,530	59,279,228
Të ardhura nga qiraja	12,618,171	14,509,813
Të ardhura shërbime konsulence	79,052,233	46,841,196
	<u>311,066,890</u>	<u>244,874,249</u>

Rakordimi i të ardhurave me FDP-në

	<u>31 dhjetor 2021</u>
Qarkullim i tatueshëm	314,072,210
shtohen te ardhura te tjera	183,803
Zbriten të ardhura nga shitja e aktiveve paraqitur neto	(3,189,123)
Shuma e qarkullimit e korrektuar	311,066,890
Sipas Kontabilitetit	311,066,890
Diferenca	-

25. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë të ardhurat të tjera të realizuara gjatë aktivitetit të shfrytëzimit si dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Të ardhura nga shitja e aktiveve (neto)	3,189,123	(373,318)
Të ardhura nga kembimet valutore aktiviteti operativ (neto)	(175,637)	(3,047,904)
Të ardhura të tjera	(8,166)	523,560
	3,005,320	(2,897,662)
 <i>Dalja jashtë përdorimit dhe shitja e aktiveve afatgjata materiale</i>		
Të ardhura nga shitja e AAM	18,226,085	6,389,550
Shpenzime nga shitja e AAM	(15,036,962)	(6,762,870)
Rezultati Neto nga shitja e AAM	3,189,123	(373,320)

26. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndeve të para dhe shërbimeve të konsumuara. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Kosto e mallrave të shitura	192,595,484	118,428,492
Blerje materiale të tjera	-	24,000
Shërbim logjistike	2,715,500	3,019,290
Karburant për logjistikën	5,703,400	5,734,200
Shpenzime për logjistikë	-	1,193,689
	201,014,384	128,399,671

27. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Mirëmbajtje dhe riparime	2,347,333	1,841,418
Personel jashtë njësisë	5,907,360	5,289,210
Transferime, udhëtime, dieta	4,940,069	780,583
Shpenzime qiraje	12,861,763	12,807,750
Shërbime bankare	905,503	697,840
Shërbime Konsulence	1,351,282	-
Taksa të ndryshme	1,776,977	3,432,817
Shpenzime pritje percjellje	948,458	-
Shpenzime të tjera	933,707	866,902
	31,972,452	25,716,520

28. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Shpenzime paga	21,924,207	39,095,889
Shpenzime per sigurime shoqerore	2,933,644	4,773,731
	24,857,851	43,869,620

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2021 është 20 punonjës. (2020: 26 punonjës)

29. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Gjopa të ndryshme	248,596	11,495
Shpenzime te tjera	1,314,092	74,102
Dhurata	563,678	-
Sponsorizime	184,830	186,150
	2,311,196	271,747

30. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Shpenzime për interesa	3,838,202	2,071,362
Të ardhura nga interesat	(290,006)	(197,577)
Te ardhura te tjera financiare	(18,556)	-
	3,529,640	1,873,785

31. Shpenzime tatim fitimit

Shpenzimi i tatim fitimit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
<i>Fitimi para tatimit</i>	39,656,314	28,611,995
Total shpenzime të panjohura	2,311,196	1,199,102
Shpenzime për dhurata	563,678	86,600
Penalitete, gjoba e dëmshpërblime	248,596	25,701
Vlera kontabël e AAM të shitura	-	648,265
Sponsorizime	184,830	199,125
Taksa makinash cash	40,200	13,206
Shpenzime të tjera	1,273,892	226,205
<i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i>	41,967,510	29,811,097
<i>Tatim fitimi @15%</i>	(6,295,127)	(4,471,664)
	33,361,187	24,140,330

32. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2021		31 dhjetor 2020	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
Abkons shpk	17,665,386	-	40,145,151	-
IKONS shpk	3,457,809	-	11,133	-
Albanian Financial Institution	-	6,231,262	82,879	13,670,517
BGP Southeast Europe shpk	724,560	-	729,830	-
Albrail	20,348,060	-	30,739,450	-
Besnik Leskaj	-	142,544,564	-	142,544,564
Blessed Investment shpk	-	31,681,200	50,000	39,584,000
GBI	7,559,737	-	7,707,266	-
	49,755,552	180,457,026	79,465,709	195,799,081

Transaksionet me palët e lidhura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	Për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2021		Për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2020	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
Abkons shpk	93,095,823	222,953	128,455,372	191,309
Albanian Financial Institution	948,222	7,935,488	2,534,089	12,906,591
Albrail	77,370	-	197,496	-
BGP Southeast Europe shpk	5,897,840	-	8,796,782	-
Matrix Konstuksion	-	5,602,114	-	7,466,446
	100,019,255	13,760,555	139,983,739	20,564,346

33. Angazhime dhe pasiguri*Çeshtje gjyqësore*

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çeshtje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 Dhjetor 2021 Shoqëria nuk ka asnjë çeshtje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

33. Angazhime dhe pasiguri (vazhdim)

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërise nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme

34. Ngjarje pas datës së bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.